



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:056225
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06226323

C-III- 21-0132

Paditësja/Propozues: Ç Zh, Ç M, P V Ç, T D, S T, T S, T V, P B dhe J M të përfaqësuar nga avokati A A K nga Prishtina.

Kundër :

Të Paditurit/ Kundërshtarë të sigurimit: KBI „Kosova Export ” Fushë Kosovë dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. Driton Hoxha nr. 55, Prishtinë .

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me kolegjin e specializuar gjyqtarin kryesues Hasim Sogojeva, dhe gjyqtarët Agron Hoxhaj dhe Bajram Miftari në lidhje me propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, në seancë vendimmarrëse më 30 shtator 2024 mori këtë :

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar propozimi i propozuesve Ç Zh Ç M, P V Ç, T D, S T, T S, T V P B dhe J M ashtu që Kundërshtarit të Sigurimit KBI „Kosova Export ” Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Prishtinë, i ndalohet tjetërsimi i ngastrës nr. , me kulturë arë klasa 2, me sipërfaqe 4774 m², që gjendet ZK L1 , Komuna e Graçanicës.

Masa e sigurimit nga paragrafi një i dispozitivit, të regjistrohet në regjistrin e palujtëshemrive në Zyrën e Kadastrit të Komunës së Graçanicës .

Rrethanat e Faktike

Më 19.04.2021, paditësit përmes të autorizuarit të tyre E G kanë ushtruar padia kundër të paditurit me të cilën është kërkuar përmbushja e marrëveshjes së arondimit dt. 29.01.1979.

Në padi kanë theksuar se paraardhësi i tyre, B M nga Ll ka lidhur kontratë – marrëveshje me KBI Kosova Export ” në Fushë Kosovë sipas të cilës paraardhësi ja ka bartë KBI-së pjesën e ngastrës që gjendet në ZK Ll me flet posedimi ., të pjesë të ngastrës nr., me sipërfaqe 1.20.00.00 ha, në vendin e quajtur „. ”klasa e 4, ndërsa KBI për ngastrës e cekur më lartë M B ja bartë në pronësi ngastrën nr., në vendin e quajtur „. ” me sipërfaqe 1,00.00ha, ft. 243, ZK Ll. Marrëveshja është vërtetuar në Gjykatën Komunle në Prishtinë më dt. 30.01.1979.

Edhe përkundër kësaj marrëveshje, bartja nuk është bërë në regjistrin kadastral me fajin e punëtorëve të KBI „Kosova Export ”

Në kërkesëpadi ka kërkuar të drejtën e pronësisë për ngastrën nr. 202-21, me sipërfaqe 4775m2.

Ka bashkangjitur :

- Marrëveshja e Arondimit Vr. 338/79 dt. 29.01.1979,
- Aktvendimin për shqyrtim të trashëgimisë T. nr., dt., të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Graçanicë .

Me dt. 26.07.2024, paditësit përmes avokatit A K kanë ushtruar propozim për caktimin e masës së sigurimit është deklaruar përkundër faktit se është ushtruar padia AKP-ja e ka publikuar tenderin për shitje të ngastrës 2002/21, me kulturë arë klasa 2, me sipërfaqe 4774m2, ZK Ll, dhe meqenëse ekziston rreziku i tjetërsimit ka theksuar se janë përmbushur kushtet për vendosje të masës.

Me propozim ka bashkangjitur :

- Publikimin për shitje të ngastrës nr. ..., me kulturë arë, klasa 2, me sipërfaqe 4775m2, ZK Ll, për NSH Ratar.

Më dt. 26.07.2024, DHPGJS, ka lëshuar Urdhër C- III- 21- 0132, si për paditësit ashtu edhe për të paditurin.

Paditësve ju është kërkuar të identifikon ngastrës lëndore objekt ndërrimi, me ekspertizë gjeodezike .

Të paditurit ju është kërkuar të jep përgjigje në padi dhe në masë të sigurimit .

Më dt. 01.08.2024, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën e përgjigjes në masë të sigurimit dhe të njëjtën e ka kundërshtuar .

Në parashtrësë është deklaruar se nuk janë plotësuar kushtet sipas nenit 61 të DHPGJS, për caktimin e masës së sigurimit në lidhje me të drejtën subjektive se ka gjasa reale për ta fituar rastin pasta për shkaktim dëmi është i pariparueshëm .

Më dt. 09.08.2024, AKP-ja ka dorëzuar edhe parashtrësën e përgjigjes në padi sipas të cilës përfaqësuesi i saj është deklaruar :

Paditësi nuk ka dorëzuar prova të mjaftueshme me padi përveç marrëveshjes për arondim, përpos që paditësi është thirr në mos zbatim të marrëveshjes për arondim .Më tej ka theksuar se ngastra nr. , ZK Ll ende gjendet në emër të NSH dhe kërkojmë historiatin e pronës . Ka kërkuar të refuzohet kërkesëpadia .

Më dt. 10.09.2024, DHPGJS ka lëshuar Urdhër C- III- 21- 0132, me të cilin avokatit A K ju është kërkuar të dorëzojë ekspertizë gjeodezike për identifikimin ngastrave kadastrale që kanë qenë objekt i arondrimi – ndërrimit si dhe skicën e matjeve për këto ngastra Për shkak se avokat nuk kishte vepruar sipas urdhrit të parë, është vendosur që ky urdhër ti dërgohet njërit prej paditësve J M por dorëzimi ka dështuar me arsyetim se adresa nuk është e sakt.

Më dt. 13.09.2024, avokati A K dorëzojë ekspertizën e hartuar nga ekspertja e gjeodezisë L Th D mirëpo kjo ekspertizë nuk i përmbush kriteret e pranueshmeris së një ekspertize gjeodezike , për shkak se ajo është shumë e mangët, nuk është identifikuar ngastra të cilën paraardhësit të paditësit ju është marrë nga KBI , pastaj nuk janë dhënë të gjitha të dhënat gjeodezike të ngastrës lëndore për të cilën kërkohet caktimi i masës së sigurimit përveç të një skice , nuk është krahasuar gjendja faktike në teren me të dhënat gjeodezike në kadastër, nuk është siguruar certifikata e pronës për njësinë kadastrale, nr. ..., dhe nuk është dhënë asnjë shpjegim se faktikisht kush është në posedim.

Më dt. 18.09.2024, DHPGJS përsëri për avokatin A K ka lëshuar urdhër por i njëjti nuk ka vepruar .

Arsyetimi ligjor

Propozimi për caktimin e masës së sigurimit pranohet

Me dispozitën e nenit 61, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-086 rregullon ,, Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Propozimi për caktimin e masës së sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet t’i referohet asaj kërkesë/ padie ”.

Gjykata bazuar në provat e ofruara nga palët ndërgjyqës ka konstatuar këtë gjendje faktike :

Paraardhësi i paditësve M G B nga Ll dhe KBI Kosova Export kanë arritur marrëveshje për arondim të vërtetuar në gjykatë me nr. 338/79, dt. 30.01.1979, ashtu që paraardhësit të paditësve, të paditurit ja ka ofruar ngastrën nr., me sipërfaqe nr. 1.20.00ha, në vendin e quajtur, .., klasa e 4, fleta e posedimit ., ZK Ll., ndërsa KBI Kosova Export për ngastrën e larte cekur paraardhësit të paditësve ja bartë të drejtën e pronësisë në ngastrën nr. . në vendin e quajtur ,, me sipërfaqe 1.00.00.ha. fleta e posedimit nr. .ZK Ll.. Ndërrimi i palujatëshmerive bëhet pa asnjë barr, dhe kompensim në të holla dhe natyrë.

Me aktvendimin për shqyrtim trashëgimie T. nr., të Gjykatës Themelore në Prishinë, Dega në Grçanicë, si trashëgimtar të trashëgimlënësit B M , janë shpallur J M M Ç, M S Z S T V D, S D S T, B P dhe D T.

Bazuar në publikimin e AKP-së, njësia nr. 25, Ratar , tokë bujqësore në ngastrën nr. ..., me kulturë arë, klasa 2, me sipërfaqe 4775m², ZK Ll është shpallur në shitje.

Paditësit kanë ofruar një ekspertizë jo të plotë gjeodezike me të cilën kanë identifikuar ngastra lëndore që është objekt i tenderimit nga AKP-ja nr. ...

Gjykata vlerëson se për caktimin e masës së sigurimit janë të nevojshme të plotësohen dy kushte ligjore dhe atë :

- Propozuesi i masës së sigurimit, duhet të jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektivë dhe
- Propozuesi duhet të jep prova, që pa caktimin e masës së sigurimit do të ketë dëme të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm, e që sipas kësaj dispozite dëmi i pa riparueshëm është vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar .

Gjykata vlerëson se sipas nenit 31.5 të Ligjit nr. 06/L 086, pala e cila e pohon ekzistimin e një fakti, ajo është e obliguar të paraqes prova fizike dhe /ose dëshmuese për mbështetjen e atij pohimi.

Në rastin konkret propozuesit e masës së sigurimit, me provat e dorëzuara kanë vërtetuar se kanë legjitimitet në kërkesëpadi dhe propozim në masë të sigurimit, ndërsa sipas marrëveshjes së arondimit të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë Vr., dt., e kanë bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës së tyre subjektive në kërkesën në ngastrën nr., ZK Ll pasi paraardhësi i tyre, ka hyrë në posedim në bazë të një pune juridike të vlefshme. Në rastin konkret kushti i parë është plotësuar për caktimin e masës së sigurimit.

Sa i përket rrezikut që pa caktimin e masës së sigurimit palës do ti shkaktohet dëmi i menjëhershëm dhe i pa riparueshëm, në rastin konkret gjykata vlerëson se dëmi mundë të jetë i pa riparueshëm me vetë faktin se AKP-ja ka shpallur tender për shitje të ngastrës lëndore vetëm pse kjo ngastër në regjistër kadastral evidentohet në emër të KBI Kosove Export e cila ngastër lëndore ju është dhënë paraardhësit të paditësit me punës juridike . Kështu që në rastin konkret edhe kushti i dytë është plotësuar për caktimin e masës së sigurimit.

Gjykata nuk caktojë ndonjë shumë si garancion për dëm eventual që mundë të pësoj AKP-ja, pasi me marrëveshje të ndërrimit ndërmjet paraardhësit të paditësve dhe KBI Kosova Export, provohet se i padituri është në posedim të ngastrës së ish paraardhësit të paditësve- propozuesve si ngastra nr., ZK Ll.

Gjykata e pranoj si të bazuar propozimin për caktimin masë së sigurimit, pasi janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e sipas nenit 61 të Ligjit nr. 06/L-086, si në paragrafin një të dispozitivit .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në afatin kohor prej 15 ditëve duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktvendimi.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar kryesues

Agron Hoxhaj , Gjyqtar

Bajram Miftari, Gjyqtar